

Anton MARKU, Vjenë

FJALA ME RASTIN E PROMOVIMIT TË ROMANIT TË BESIM XHELILIT “1803”

Hamburg: 12.03.2016

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës,
Të nderuar diplomatë të Ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës në Gjermani,
Të nderuar udhëheqës dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme shqiptare në Gjermani,
Të nderuar aktivistë, intelektualë dhe studentë,
I nderuari Kryetar i Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë,
Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë që para jush të paraqes një vështrim të shkurtër lidhur me romanin e parë të poetit, tash dhe prozatorit (romancierit), mikut tonë Besim Xhelili, i cili vjen nga Tetova, ndërsa ka më se 18 vite që jeton dhe vepron në Vjenë. Pos tjerave, Besimi për katër vite ka qenë dhe kryetari i parë i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri “Aleksandër Moisiu” dhe që nga muaji i kaluar (shkurt 2016) edhe është pranuar anëtar i rregullt i PEN Klubit të Austrisë. Kësaj radhe do të prezantohet vepra e titulluar “1803”, e cila u botua në fillim të këtij viti.

Vetë titulli i romanit “1803” është disi i mistershëm, por mbase jo dhe aq i vështirë për t’u deshifruar. Ai do ta përcjell lexuesin hap pas hapi duke përshkruar 75 kapitujt e këtij libri që në fokus ka temën e përrjetshme të njerëzimit - dashurinë.

Vendngjarjet kryesore të romanit dhe gjeografia e rrëfimit të tij janë kryesisht dy metropole të bukura evropiane: Vjena dhe Kopenhaga. Por, nuk mungojnë as skena dhe udhëpërshkrime nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Gjermania, etj., për të përfunduar në SHBA, në Nju Jork. Në roman parakalojnë edhe qytete e krahina shqiptare, peizazhe, toponime malesh e bjeshkësh, lumenjsh e fushash, monumente historike e trashëgimore. Parakalojnë emra krijuesish e librash, po edhe karakteresh nga popuj të ndryshëm.

Në aspektin tematik romani kryesisht trajton dashurinë dhe sfidat që ajo di dhe mundet të sjell. Që në fillim të librit autori dashurinë e quan “forcë hyjnore që dhuron gëzim dhe lumturi”. Më pas në narracion përshkruhen edhe raportet mes individit, familjes dhe shoqërisë. Një vend të posaçëm zë edhe përditshmëria në vendin e punës, jeta në mërgim, etnia, kultura, arti, poezia, jeta urbane, etj.

Romani është shkruar në veten e parë dhe për kryepersonazh ka Besarin, i cili jeton në Vjenë. Personazhi tjetër që plotëson kryeprotagonistin është Samira, e cila jeton në Kopenhagë. Të dy protagonistët e dashuruar (njihen e takohen rastësisht në një orë letrare), kanë familjet e tyre, kanë fëmijët dhe jetën e tyre bashkëshortore. Në këtë aspekt, autori e ruan gjer në fund kujdesin e ndjeshmërisë së një lidhje të tillë raportesh e marrëdhëniesh, duke ardhur në përfundim se “në dashuri nuk bën të ndjehet i lënduar askush”.

Në përgjithësi, studiuesit dhe kritikët letrarë pajtohen se në roman e rëndësishme është tërësia, jo detajet. Sidoqoftë, në këtë vepër “kryeprogonistët e jetojnë dhe e përjetojnë jetën e tyre emocionale përafërse, si dhe dëshirat e tyre; për ta nuk ka kohë, as natë, as ditë, as të djeshme e as të ardhme, ka vetëm çaste të mbushura me bukurinë e emocionit (bisedat me telefon, emailt, letrat, poezitë, thëniet dashurore, video-bisedat, deri te takimet e rralla...largësia zhduket). Megjithatë, kah fundi i romanit, askush askënd nuk e akuzon për këtë dashuri, por përkundrazi triumfon mirëkuptimi!” (P.B)

Ky roman të tërheq me mënyrën e të shkruarit, me subjektin, personazhet dhe emocionet që ai ofron. Pra, nëse pajtohem se letërsia duhet të jetë e bukur dhe të ngjallë ndjenja gjatë leximit, kjo arrihet pothuajse plotësisht në këtë roman. Duket se autori i këtij libri, më shumë se sa kërkues i inspirimit, është pritës i durueshëm i tij. Por, sapo që frymëzimi ta pushtojë, ai zhytet i tëri në shkrim dhe përkthen ndjenjat në fjalë, fjalët në rreshta e rreshtat në kapituj letrarë duke ruajtur gjithmonë një nivel të lartë artistik në rrëfim.

Stili i shkrimit është modern. Pas pjesës së parë të romanit, i cili është kryesisht udhëpërshkrues, monologjet dhe dialogjet janë të shpeshtë dhe përmes tyre njihemi më për së afërmi me karakteret e personazheve e që njëkohësisht tregojnë edhe dramën e brendshme intime.

“Edhe pse kjo është vepra e parë në prozë e Besim Xhelilit, ky roman dëshmon për prirjet e një prozatori të kujdesshëm, që di çka kërkon nga lënda e trajtuar. Romani lexohet lirshëm sado që mbaron me një happy end, megjithatë lihet e lirë mundësia e vazhdimit të tij.” (P.B)

Romani komunikon shumë mirë me lexuesin dhe me plot bindje do i sugjeroja secilit që atë ta lexojë në mënyrë që të njihet me një histori të veçantë dashurie, sado që mbase dhe fiktive. Ai pritët që shumë shpejt të përkthehet edhe në gjuhën gjermane, çka do të bënte të mundur që edhe lexuesi gjermanofolës të njihet më për së afërmi me një pjesë të letërsisë sonë të krijuar në mërgim. Recensionin e romanit e ka bërë kritiku i njohur letrar nga Kosova, Prend Buzhala.

Rëndësia e publikimit të këtij libri qëndron në faktin se ai është ndër të parët e këtij lloji i botuar viteve të fundit nga një shkrimtar shqiptar në Austri, kjo dhe për faktin se në letërsinë shqiptare të krijuar në këtë shtet, dominon poezia me aty-këtu ndonjë tregim të shkurtër. Për më tepër, ky libër pasuron fondin e botimeve të autorëve shqiptarë nga diaspora.

Ata që janë kureshtarë të mësojnë se si përfundon ky rrëfim i vrullshëm dashurie, kanë rastin unik që atë ta kenë që sot në duart e tyre. Çmimi për një ekzemplar është _____ euro.

Mbase ky nuk do të jetë libri më i mirë që keni lexuar deri më tani. Ai as që pretendon të jetë i tillë. Megjithatë, jam i sigurt se ai do të jetë ndër ata nga më të veçantët që mund ta keni shfletuar ndonjëherë.

Autorin e këtij romani e përgëzoj për botimin e kësaj vepre dhe i uroj shëndet dhe sukses në jetë dhe krijimtarinë e tij artistike.

Faleminderit për vëmendjen tuaj!